

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga Haris Vongli - Monologu ...i atyre që i ikin!
ADRESA	https://www.syri.net/politike/919236/monologu-hellip-i-atyre-qe-i-ikin/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 20:13:46 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 20:05:37 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7e4cfd3774108a493c3211932eba028daec897add561a2ccc674d2157d37da75
TEKSTI	369b705c4cd19d53be9b6f5ff048e2bfe827db0daa1813ddca304fa403b8b3e7
PAMJA	1570f5105878e7cca77baaa10de7e1b87ed4cb4f1f83aee7a3e43e353cc6809f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	91d31546bd5ffc924a1947ada0a4570d83479dfc4a718bbc467166e735d74fa1
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f25232b47d2959dc6146897981a0af4e37060d45058c64d9459ab0f54fd17f54
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/91d31546bd5ffc924a1947ada0a4570d83479dfc4a718bbc467166e735d74fa1>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**NDRIÇIM KULLA**

Dorëheqja urgjente e Edi Ramës nuk është më vetëm një kërkesë e opozitës, por edhe e ndërkombëtarëve

**ENVER BYTYÇI**

Vendimi i Hagës dhe raporti ynë me të vërtetën!

LAJMI I FUNDIT**PIRANJAT/ Me Florian Binaj dhe Dojna Mema****më të lexuarat**

'Iu hoq cipa e maskës mazhorancës', Goxhaj: Po i vjen fundi kësaj kaste, Rama s' menaxhon dot më



Mashtrimi me shëndetësinë falas: Shqipëria e dyta në Europë për koston e lartë



Akuzat ndaj shefes së SHISH vënë në pikëpyetje sigurinë kombëtare të Shqipërisë



'Qeveria braktisi qytetarët përballë çmimeve', aktivisti: Shqipëria mban TVSH-në 20% për shportën bazë



Akuzat për shëfën e SHSH, Ndoja: Kjo është rënia e shtetit, është bashkuar me krimin



Fati i bashkëpunëtorëve kosovarë të Ramës

**Monologu ...i atyre që i ikin!**

22:05, 25/09/2026

ZMADHO TEKSTIN**Nga Haris Vongli**

Unë quhem Haris Vongli dhe kam ikur 3 herë nga Shqipëria.

Herën e parë, isha vetëm __18_ vjeç.

Ika, për një sistem arsimor më të mirë. Prindërit mëpërcollën deri tek kufiri, në aeroport. Nuk i pushuan lotët, teksa më shihnin me valixhe në dorë – për ta isha shumë e vogël – por më tepër, sepse ishin të bindur që nuk do kthehesha më.

Po unë u ktheva, edhe pse askush nuk e priste. Shoqet e mia iknin, unë u ktheva, me ëndrrën jo vetëm të ndërtoj një jetë por dhe të luftoj për ta ndryshuar Shqipërinë gofë dhe përmes politikës. Por ëndrrat shpejt ia lanë vendin zhgënjimit. Nuk humba vetëm punën, por dhe shpresën se diçka mund të ndryshonte. Ndaj vendosa të iki për herë të dytë. Këtë radhë, më kishin vrarë të sotmen. Ime më, më përcolli deri te dera: unë përsëri me valixhe në dorë.

U arsimova dhe më shumë, punova, kërkova një vend që të më zëvendësonte Shqipërinë, por nuk ishte e lehtë. Mendjen e kisha akoma këtu, tek njerëzit e mi, tek vendi im. Dhe prapë, shpresa - ajo që thonë se vdes e fundit - më bëri të rikthehem në Tiranë, këtë radhë me ëndrrën për të ndërtuar një jetë akademike.

Kur erdha, e gjeta Universitetin të dërgjur... Gjeta një mungesë të madhe të dëshirës për të dhënë e prodhuar dije. Kërkova të bëja një doktoraturë. Por nuk ma dhanë atë shans.

Ik, më tha mami me zemër të thyer, ik atje ku shanset ekzistojnë. Ndaj mora valixhen për herë të tretë, e bindur që shpresën ma kishin vrarë përfundimisht.

Tani jetoj në Londër, mbrojtja doktoraturën ndërsa kam dhënë mësim në 'Glasgow Caledonian University' dhe tani në 'Health Science University'.

Edhe sot pas shume vitesh, kur shoh pas, kuptoj që pjesën më të madhe të jetës e kam kaluar me valixhe në dorë. Nëpër botë kam takuar qindra shqiptarë si unë. Edhe ata e mbajnë kokën pas. Me një dashuri të madhe, e pamundur për tu

kuptuar kur jeton këtu – një dashuri për mallues, gati mbytëse, për këtë vend nga kemi ikur!

Ne vërtet ikëm, por jetojmë të ndarë më dysh: me zemër e me mendje jemi edhe andej edhe këtej – kemi mundim të dyfishtë... kemi 2 shtëpi, kemi 2 familje, kemi dy histori, një jashtë e një brenda... dhe kemi mbetur varur, as andej e as këtej.

Të gjithë ne, do donim të ktheheshim... për të kontribuar këtu. Me dijet, me personalitetin e integritetin tonë. Por, kur vijmë gjejmë të njëjtat probleme që na kanë detyruar të ikim. Dhe nuk janë vetëm hallet në dukje të "vogla" të së përditëshmes: uji, dritat, çmimet, kanalizimet, shkollat e spitalet. Jo. Sëmundja tashmë ka pushtuar krejt ngrehinën.

Problemi nuk është më vetëm Rama që ka kapur pushtetin si një pronë private...

Por, është dhe ai tjetri që ka kapur median...

Ai tjetri që ka kapur shëndetësinë...

Ai tjetri që ka kapur sportin...

Ai që ka kapur teatrin...

Ai që ka kapur universitetin...

Ai që ka kapur teknologjinë...

Çdo hallkë e shoqërisë është e kapur, si modeli i Ramës. Me njerëz që rrinë përjetësisht në krye të çdo sektori. Dhe qeverisin bashkë. Dhe na përjashtojnë, bashkë.

Por, protestat...

Protestat...

Aty ku takoj tërë ata që i kam pasë takuar me valixhe në duar në dekadat e mërgimit...

Kjo ëndërr për një Shqipëri të re...

Po më bind të kthehem dhe një herë të katërt!

Ne nuk duam të kthejmë sindromën e vitit zero.

Ne duhet të kthejmë trurin. Kjo kërkon një sakrificë. Shqipëria duhet të rinohet. Kjo mendësi mund të zhbëhet vetëm nëse më të mirët nga ne kthehen dhe vendosin ta ndryshojnë, bashkë me ata që nuk kanë ikur akoma.

Dhe ky është shansi i fundit.

Për të ndërtuar një Shqipëri tjetër.

Jo më vetëm për vete, por dhe për tim bir, Davidin. Dua që im bir të rritet prane njerezve te tij, me gjakun e vet; gjyshërit, kushurinjtë, të komunikojë me ta në shqip dhe mos e ndërtojë gjithashtu personalitetin e tij me valixhe nëpër duar. Davidi duhet të jetë i qartë se ku përkëtdhe të ndihet plot në shpirt. Në tokën e vet. Me diellin e vet.

© SYRI.net

Lexo edhe:



SYRI TV/ Pikëpyetje për shpenzimet në Portin e Durrësit, 178 mijë euro për panele, 88 mijë euro humbje



Si e fyeu Edi Rama, 'Makiaveli shqiptar', Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara



Rama zhgënjën mediat në Prishtinë: Kosova pa zë në OKB, asnjë fjalë për UÇK-në

Si kontrasti Guillaume/Hyseni shpjegon Shqipërinë 2026

Çmimet stratosferike në Shqipëri, Kedhi: Jemi në një krizë të madhe, ekonomike, sociale e demografike

Në gjithë Kosovën sot protestohet kundër vendimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së

TË NGJASHME



'Krejt radarët e shtetit i mbyll për ty'/
Kush mban përgjegjësi për skandalin
e SHISH?



'Fjalim lamtumire në OKB?'/ Harxhi:
Nga podiumi global, Shqipëria nuk
mund të fshihet pas propagandës

Konjufca në New York: Aktgjykimi
ndaj ish-krerëve të UÇK-së është
padrejtësi që duhet të korrigjohet



FOTO-VIDEO/ Rama flet 'me veten'
në OKB, mban fjalim para një salle të
boshatisur

VIDEO/ Mban titullin 'doktor
shkencash', Taulant Balla e ka
kopjuar dizertacionin nga një punim
shkencor europian



Presidenti/ Hamza: Do i përshtatim
qëndrimet pasi jemi në rrethana të
reja, i gatshëm për takime

Mbyllen fjalimet/ Shiu s'i pengon
qytetarët të marshojnë nëpër Tiranë:
Rama, jepe dorëheqjen!

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do t'i gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.